



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/137;
Datë: 26.05.2017.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-180/4046	1	21.05.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 7 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.05.2017 nxjerrë:

VENDIM

për formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2018

- I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2018/në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.
- II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2018 në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.
- III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, një përfaqësues nga ekzekutivi i komunës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike dhe kryesuesja e Grupit të Femrës së Komunës së Junikut.
- IV. Afati i hartimit të (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut është më së largu deri në fund të muajit shtator të këtij viti.
- V. Pas hartimit të (projekt) Planit të punës nga ana e Grupit të punës, (projekt) Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Por.	Nr.i faq	Data
2-1824047	2	31.05.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/136;
Datë: 26.05.2017.

Në bazë të neneve 11 dhe 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 14 paragrafi 14.1 të Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në komunën e Junikut dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.05.2017 nxjerrë:

V E N D I M

për ndarjen e Çmimit "Nderi i Junikut"

I. Me këtë vendim iu ndahet Çmimi "Nderi i Junikut" të gjithë të rënëve në Junik për lirinë e Kosovës nga viti 1990 e deri më sot.

I.1. Heronjtë e Kosovës: Arif (Demush) GJOÇI; Avdyl (Ali) JASIQI; Bedri (Veli) SHALA; Bekim BERISHA; Edmond (Hysni) HOXHA; Elton (Gëzim) ZHERKA; Fadil (Halil) MALOKU; Përmet VULA; Shaban MAZRREKAJ dhe Shkelzen (Rexhë) GACAFERI.

I.2. Dëshmorët: Adem (Idriz) JASIQI; Bajram (Isuf) VELIJAJ; Bajram (Zenun) HOXHA; Bastri (Hajzer) BEQIRI; Bashkim (Avdi) LEKU; Bashkim (Ramadan) JASIQI; Besnik (Sali) JASIQI; Bujar (Sali) JASIQI; Gëzim (Miftar) PEP SHI; Isa (Zyber) TOFAJ; Ismet (Qaush) GJOÇI; Jahë (Binak) TOFAJ; Mehmet (Zekë) ZEKAJ; Musë (Ali) GANIJAJ; Qaush (Sali) QESTAJ; Sadik (Ramë) GANIJAJ; Sokol (Kadri) GANIJAJ; Xhafer (Bekë) KRASNIQI dhe Zejrije (Osman) KRASNIQI.

I.3. Martirët: Agim (Hasan) SHEHU; Ahmet (Deli) SHEHU; Ajmane (Shaban) SHALA; Ali (Malë) KRASNIQI; Ardian (Bajram) HOXHA; Artan (Ramë) MALOKU; Bajram (Ramë) SHEHU; Blendi (Shkelzen) KRASNIQI; Blendian (Bajram) HOXHA; Blerim (Asllan) MALOKU; Brahim (Isuf) MIROCI; Brahim (Muharrem) GAXHERRI; Bujar (Beqë) SHEHU; Bukuriye (Ali) GJOTA; Burim (Brahim) MALOKU; Demë (Ali) GJOÇI; Dervish (Osë) QESTAJ; Fadil (Hamdi) HOXHA; Faredin (Magjun) MIROCI; Fitim (Sadik) HOXHA; Gafurr (Rrustem) HYKOSMANI; Hajdar (Nimon) QESTAJ; Hajrullah (Hysni) HOXHA; Halil (Mehmet) KUÇI; Hasan (Hajdar) GAXHERRI; Hasan (Ibrahim) KUÇI; Hate (Mehmet) SHALA; Haxhi (Avdullah) FETAJ; Hysen (Ukë) KRASNIQI; Imer (Hazer) MALOKU; Ismet (Hasan) SHEHU; Ismet (Lahë) MIFTARI; Isuf (Elez) MIROCI; Jakute (Rizë) GJOTA; Milaim (Gjemë) HOXHA; Muharrem (Mehmet) SHALA; Naim (Hysni) HOXHA; Nimitullahë

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>

(Dervish) MIROCI; Osman (Jakup) SALIHAI; Petrit (Hajdar) MALOKU; Qaush (Arif) BAJRAKTARI; Ramë (Selmon) MALOKU; Ramiz (Shaban) HOXHA; Rexhep (Adem) TOFAJ; Rifat (Iliaz) HOXHA; Sabrie (Shkelzen) KRASNIQI; Sadik (Selim) SALIHAI; Sali (Zekë) SALIHAI; Sokol (Ramë) MIROCI; Shkelzen (Mehmet) KRASNIQI; Shkurte (Ali) KRASNIQI; Shpend (Avdyl) KUÇI; Time (Dervish) BAJRAKTARI; Vlora (Shkelzen) KRASNIQI; Xhafer (Adem) GAXHERRI dhe Xhafer (Ali) KRASNIQI.

II. Të lartpërmendurit nga pika I. e këtij vendimi kanë dhënë kontribut të çmuar heroizmi, humanizmi dhe sakrifice sublime në çlirimin e vendit nga okupatori.

III. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që t'ua dorëzoj çmimin "Nderi i Junikut" familjarëve të personaliteteve nga pika I. e këtij vendimi në ndonjë datë të shënuar të Komunës së Junikut.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Familjarët e personaliteteve që u ndahet ky çmim;
2. MAPL;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues

